

Vendim nr. 200, datë 15.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahimi, Anëtar

Ilir Toska, Anëtar

në datën 15.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (B) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: BLEDAR MUHAMETI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1310, datë 24.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 1312, datë 18.11.2015 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-2342, datë 18.06.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë me tjetër trup gjykues ose në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 7, 42, 43, 116, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 49, pika 3, shkronja “c”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Bledar Muhameti është një nga trashëgimtarët ligjorë të shtetasit Sh.M. Këtij të fundit, me dekretligjin nr. 597, datë 28.04.1948, i është falur pa shpërblim një sipërfaqe toke prej 394 m², e ndodhur në lagjen Skelë-Kumë, Vlorë. Ky akt juridik është regjistruar në regjistrat hipotekarë të kohës sipas notës së transkriptimit të datës 16.08.1948. Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar, një nga trashëgimtarët e Sh.M., shtetasi F.M., i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 658, datë 11.03.1994, ka vendosur detyrimin e Bashkisë së Vlorës për ta njohur atë pronar të truallit me sipërfaqe 1560 m², ku ndodhej shkolla “1 Maji”, Vlorë.

2. Në vijim, duke u mbështetur edhe në këtë vendim gjyqësor, trashëgimtarët e ish-pronarit Sh.M. i janë drejtuar Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (KKKP) pranë Bashkisë së Vlorës për njohjen e pronësisë, kthimin ose kompensimin e pronës. Me vendimin nr. 88, datë 04.10.1995, KKKP-ja, Vlorë ka vendosur të mos u njohë dhe të mos u kthejë trashëgimtarëve të Sh.M. sipërfaqet prej 394 m² dhe 1560 m² në lagjen “Skelë”, Vlorë. Pas kundërshtimit gjyqësisht të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Vlorë, me vendimin nr. 2906, datë 23.10.1996, ka anuluar vendimin e KKKP-së, Vlorë dhe u ka njohur trashëgimtarëve të Sh.M. të drejtën e pronësisë mbi dy pasuri, konkretisht mbi truallin me sipërfaqe 1560 m², në lagjen “Pavarësia”, me kufizimet përkatëse dhe mbi truallin me sipërfaqe 394 m², në Skelë-Kumë, Vlorë, me kufizimet përkatëse, duke ua kthyer atyre këto pasuri në natyrë. Më pas, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 826, datë 24.12.2004, ka vendosur ndreqjen e gabimit në vendimin nr. 2906, datë 23.10.1996.

3. Në bazë të këtyre vendimeve gjyqësore, pasuritë janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme sipas sistemit të ri të regjistrimit, në favor të trashëgimtarëve Muhameti. Më pas, ato janë pjesëtuar ndërmjet bashkëpronarëve në pesë pasuri, duke u regjistruar secila prej tyre në pronësi të bashkëpronarit përkatës. Ndërkohë, në datën 07.11.2008, ndërmjet trashëgimtarëve bashkëpronarë T.M., S.M., M.P. dhe kërkuesit Bledar Muhameti, nga njëra anë, dhe dy shoqërive, nga ana tjetër, është lidhur një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e një pallati sipas lejes së ndërtimit, në të cilën janë përcaktuar edhe pjesët takuese të pronarëve të truallit. Me

aktmarrëveshjen e datës 09.04.2010, sipërmarrësit i kanë kaluar një shoqërie tjetër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes. Pronarët e truallit kanë dhënë pëlqimin për këtë kalim me aktmarrëveshjen e datës 04.11.2010, ndërsa me aneksin e kontratës, datë 02.04.2011, kanë përcaktuar me sipërmarrësin e ri pjesët konkrete takuese të objektit të ndërtuar.

4. Nga ana tjetër, shtetasi S.Xh. ka ngritur pretendime pronësie për një pjesë të kësaj pasurie. Sipas certifikatës së pronësisë të datës 01.03.2011, ai rezultonte pronar i pasurisë “truall” me sipërfaqe të përgjithshme 278 m², nga të cilat 68,8 m² sipërfaqe ndërtimi, të ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Vlorë. Origjina e pronësisë së tij lidhet me kontratën noteriale të dhurimit të datës 18.08.1994, me të cilën nëna e tij, I.Xh., i kishte dhuruar një shtëpi me dy dhoma dhe një kuzhinë, me oborr, me sipërfaqe 210 m², të ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Vlorë, me kufij të përcaktuar. Shtetasja I.Xh. e kishte fituar pronësinë mbi këtë pasuri nëpërmjet blerjes së saj, së bashku me shtetasin E.Xh., nga shtetasja H.F., sipas notës së transkriptimit nr. 115, vol. XIX, datë 04.12.1958. Sipas kësaj note, prona e tjetërsuar përbëhej nga 434 m² oborr dhe gjysma e një shtëpie prej tri dhomash e një kuzhinë, pronë të cilën I.Xh. dhe E.Xh. e kishin pjesëtuar më pas vullnetarisht. Nga ana e saj, shtetasja H.F. e kishte fituar pronësinë mbi një vresht, të ndodhur në lagjen “Skelë”, Vlorë, përmes kontratës noteriale nr. 146116/3678, datë 16.10.1934, referuar notës së transkriptimit nr. 292, vol. IV, të vitit 1934.

5. Duke pretenduar se mes pronës së tij dhe pasurisë së familjes Muhameti kishte mbivendosje, shtetasi S.Xh. i është drejtuar fillimisht me ankim Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Vlorë. Me urdhrin e datës 03.12.2009, regjistruesi i asaj zyre ka vendosur kufizim për pasurinë e T.M. derisa të merrej një përgjigje nga kryeregjistruesi. Në vijim, me vendimin nr. 42, datë 12.02.2010, kryeregjistruesi ka vendosur fshirjen e regjistrimit të dy pasurive në emër të bashkëpronarëve Muhameti, konkretisht të pasurisë nr. 27/340/2, vol. 28, faqe 86, në emër të S.M., dhe të pasurisë nr. 27/340/3, vol. 28, faqe 87, në emër të M.M., për pjesën me sipërfaqe 114 m². Sipas këtij vendimi, fshirja e regjistrimit duhet të bëhet për shkak se mes pasurisë së ankuesit S.Xh. dhe pasurive të bashkëpronarëve Muhameti krijohet mbivendosje, ndërkohë që si bazë për regjistrimin e pasurive të familjes Muhameti kishin shërbyer vendimet nr. 2906, datë 23.10.1996 dhe nr. 826, datë 24.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, kurse për regjistrimin e pronësisë së ankuesit S.Xh. kishte shërbyer kontrata e dhurimit, ndërsa titulli i pronësisë së dhurueses rridhte nga regjistrimi i kryer në datën 04.12.1958. Mbivendosja, sipas këtij vendimi, ishte për sipërfaqen 114 m².

6. Krahës kësaj, shtetasi S.Xh. i është drejtuar gjykatës me padi kundër të paditurve Muhameti dhe shoqërisë sipërmarrëse, si dhe Bashkisë së Vlorës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, me objekt, ndër të tjera: lirimin dhe dorëzimin e sendit, konkretisht sipërfaqes së truallit 114 m², si dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme; pushimin e cenimit të pronësisë; shpërblimin e dëmit sipas parashikimeve të neneve 608 dhe 640 të Kodit Civil (KC), referuar konkluzioneve të aktit të ekspertimit, duke i dorëzuar sipërfaqet ndërtimore përkatëse për shkak të zënies së pronës me sipërfaqe 114 m²; pagimin e fitimit të munguar për shkak të vonesës në dorëzimin e pjesëve takuese sipas aktit të ekspertimit; detyrimin e të paditurve për ta njohur paditësin pronar të truallit 114 m²; pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së sipërmarrjes; pavlefshmërinë e vendimeve për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit; marrjen e masës provizore për të mos lejuar veprime mbi pronën objekt gjykimi pranë ZVRPP-së, Vlorë; pezullimin e punimeve të ndërtimit mbi objektin që po ndërtohej. Gjatë gjykimit paditësi ka hequr dorë nga kërkimi për kthimin fizik të sipërfaqes së truallit dhe nga kundërshtimi i akteve administrative, duke kërkuar dëmshpërblimin në vlerë monetare për shkak të pamundësisë së kthimit të saj.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1310, datë 24.07.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke: konstatuar pavlefshmërinë absolute të pjesshme të kontratës së sipërmarrjes të datës 07.11.2008 dhe të akteve që e kishin rikonfirmuar atë, për pjesën që disponohej mbi të drejtat e pronësisë së paditësit S.Xh.; detyruar të paditurit Muhameti dhe shoqërinë sipërmarrëse ta njohin paditësin pronar të sipërfaqes së tokës “truall” prej 114 m², siç individualizohej në aktin e ekspertimit; detyruar të paditurit të dëmshpërblenin solidarisht paditësin: për truallin e zënë prej 114 m², në shumën 57.354 euro; për cenimin e pronësisë, në shumën 36.000 euro; për fitimin e munguar, në shumën 25.000 lekë në muaj, nga data 30.05.2013 deri në ekzekutimin e këtyre detyrimeve. Nga ana tjetër, gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë ndaj Bashkisë së Vlorës, ndërsa ka pushuar gjykimin për kërkimet nga të cilat paditësi kishte hequr dorë gjatë gjykimit.

8. Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paditësi kishte arritur të provonte fitimin në mënyrë të ligjshme të së drejtës së pronësisë mbi truallin me sipërfaqe 278 m², nëpërmjet kontratës së dhurimit dhe regjistrimit të pasurisë pranë ZVRPP-së, Vlorë, pjesë integrale e së cilës ishte edhe sipërfaqja 114 m², mbi të cilën të paditurit kishin ndërtuar pallatin 8-katësh. Për sa u përket të paditurve, gjykata ka vlerësuar se mënyra e fitimit të pronësisë sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës nuk mund të vepronte duke njohur si pronarë subjekte

të tjera mbi pasuri që ishin në pronësi private. Për këtë arsye, ajo ka vlerësuar se titulli i pronësisë të të paditurve, në pjesën që krijonte mbivendosje me pasurinë prej 114 m² të paditësit, ishte akt absolutisht i pavlefshëm, i nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin dhe në kapërcim të kompetencave të organit që e kishte nxjerrë. Për rrjedhojë, edhe veprimet juridike të kryera nga të paditurit në lidhje me këtë pasuri ishin absolutisht të pavlefshme dhe nuk prodhonin pasoja juridike që nga fillimi. Ajo gjykatë ka vlerësuar, gjithashtu, se kthimi fizik i sipërfaqes 114 m² ishte bërë i pamundur për shkak të transformimit të saj nga ndërtimi i pallatit, ndaj paditësi duhej të kompensohej me ekuivalentin monetar prej 57.354 eurosh. Për sa i përket cenimit të pjesës tjetër të pasurisë, ajo është mbështetur në aktin e ekspertimit, sipas të cilit ndërtimi kishte cenuar distancat urbanistike, aksesin me automjet, orientimin, gjendjen e fqinjësisë dhe kushtet higjieno-sanitare të pronës së paditësit, duke përcaktuar dëmshpërblimin prej 36.000 eurosh. Fitimi i munguar prej 25.000 lekësh në muaj është përlogaritur mbi bazën e vlerës së qirasë të sipërfaqeve përkatëse, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit. Kundër vendimit kanë paraqitur ankim të paditurit T.M. dhe kërkuesi.

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1312, datë 18.11.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka vlerësuar se ndryshimi i objektit të padisë, nëpërmjet heqjes dorë nga kthimi fizik i sipërfaqes dhe kërkimit të dëmshpërblimit monetar, ishte i ligjshëm. Sipas saj, të dyja palët dispononin tituj pronësie për sipërfaqen 114 m², por titulli i paditësit kishte origjinë më të hershme dhe të qartë ligjore, që fillonte me kontratën e vitit 1934 dhe vijonte me kontratën e dhurimit të vitit 1994, ndërsa titulli i të paditurve rridhte nga vendimet e mëvonshme të kthimit të pronës. Për rrjedhojë, ajo ka rrëzuar pretendimet e të paditurve për vlefshmërinë e titujve të tyre të pronësisë mbi pronën objekt gjykimi, duke vlerësuar se ishin dhënë në kundërshtim me ligjet për kthimin e pronave dhe nuk mund të prevalonin ndaj pronësisë së fituar më parë, në mënyrë të ligjshme, nga paditësi. Gjykata e apelit ka vlerësuar, gjithashtu, se ndërtimi e kishte bërë të pamundur kthimin fizik të të gjithë sipërfaqes prej 114 m², ndaj ishte i drejtë dëmshpërblimi prej 57.354 eurosh. Ajo ka konfirmuar edhe cenimin e pronësisë së paditësit për shkak të humbjes së aksesit me automjet, mosrespektimit të distancave urbanistike dhe cenimit të kushteve të ndriçimit, ventilimit e higjienës, si dhe dëmshpërblimin përkatës prej 36.000 eurosh dhe fitimin e munguar prej 25.000 lekësh në muaj. Sipas saj, leja e ndërtimit nuk legjitimonte cenimin e së drejtës së pronësisë së paditësit, e cila gëzonte mbrojtje të plotë edhe në mungesë të kontestimit të lejes së ndërtimit. Kundër vendimit kanë paraqitur rekurs të paditurit T.M. dhe

kërkuesi, të cilët kanë paraqitur edhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Paditësi S.Xh., nga ana e tij, ka paraqitur kundërrekurs.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 236, datë 12.05.2016, ka vendosur mospranimin e kërkesës për pezullim, kurse me vendimin nr. 00-2025-2342, datë 18.06.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), sipas formulimit në fuqi në kohën e paraqitjes së tij. Sipas atij kolegji, gjykata e apelit kishte respektuar ligjin procedural dhe atë material dhe nuk evidentoheshin shkelje të rënda të normave procedurale. Për pjesën e pretendimeve të rekursit që ngrinte çështje të vlerësimit të provave Kolegji Civil ka vlerësuar se dilte jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, pasi gjykimi në atë gjykatë nuk mund të shërbente për rihapjen e shqyrtimit dhe rivlerësimin e provave.

11. Në datën 24.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 14.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është *cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor*, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, çka ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së pronës private, të parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Së drejtës së aksesit dhe parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykatat kanë vlerësuar në mënyrë të njëanshme vetëm provat e paditësit, duke dhënë vendime gjyqësore të pavlefshme dhe të paarsyetuara. Ato kanë pranuar se të dyja palët dispononin tituj pronësie, por nuk kanë arsyetuar përse titulli i pronësisë të të paditurve ishte i pavlefshëm. Vendimet janë bazuar në një akt ekspertimi me të meta të theksuara dhe rezultate teknike fiktive, duke anashkaluar çështjen nëse ekzistonte mbivendosje ndërmjet pronave për sipërfaqen 1560 m², e cila buronte nga vendimi gjyqësor i formës së prerë i vitit 1994 për njohjen e pronësisë. Eksperti është shprehur se kishte mbivendosje ndërmjet pronës së paditësit dhe sheshit të ndërtimit, ku ky i fundit nuk përbën titull pronësie. Për një nga detyrat e tjera kryesore eksperti është shprehur se “*mungon harta e vjetër e vitit 1960; aplikimi i pronave ndërgjyqëse nuk mund të*

bëhet sipas titujve të pronësisë”. Pavarësisht kundërshtimeve ndaj aktit të ekspertimit dhe konkluzioneve të tij, gjykatat, duke mos pranuar riekspertimin, kanë marrë vetë rolin e ekspertit. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, edhe pse, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, duhej të kontrollonte mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit. Për këtë shkak, kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet që lidheshin me mohimin e origjinës së pronës dhe konstatimin e një mbivendosjeje fiktive, me pasoja të rënda ekonomike dhe psikologjike për të.

12.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi është mohuar padrejtësisht origjina e pronës për sipërfaqen 1560 m², e cila buron nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe notat e transkriptimit të viteve 1938 dhe 1948, akte që rikonfirmojnë të drejtën e vjetër të pronësisë së ish-pronarit Sh.M. Gjykatat kanë gabuar kur e kanë përcaktuar momentin e fitimit të pronësisë së kërkuesit pas vitit 1994, pasi vendimi i KKKP-së përbën thjesht rikonfirmim të të drejtave të mohuara të pronësisë. Shkresa e Arkivit Qendror Shtetëror për pronësinë e Sh.M. që prej vitit 1934, përpara zbatimit të reformës agrare, si dhe notat e transkripimit të viteve 1938 dhe 1946 për pronat kufitare, të administruara në dosjen gjyqësore, vërtetojnë origjinën e vjetër dhe të pakontestueshme të pronësisë së Sh.M. Paditësi është pajisur me certifikatë pronësie në datën 01.03.2011, ndërsa trashëgimtarët Muhameti në datën 12.12.2007. Për rrjedhojë, nëse do të kishte mbivendosje, paditësi, si i dyti për nga koha e regjistrimit, nuk do të pajisej me certifikatë pronësie, por regjistrimi do t’i ishte refuzuar. Gjykatat nuk janë shprehur për këto pretendime dhe për shkaqet e ankimit e të rekursit dhe nuk kanë argumentuar rrëzimin e tyre, duke mohuar kështu origjinën e pronës.

12.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimet nr. 658, datë 11.03.1994 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, për njohjen e pronësisë për sipërfaqen 1560 m², nr. 2906, datë 23.10.1996, për kundërshtimin e vendimit të KKKP-së, Vlorë dhe kthimin në natyrë të kësaj sipërfaqeje, si dhe nr. 826, datë 24.12.2004 për ndreqjen e gabimit janë vendime të formës së prerë, me të cilat prona u është kthyer në natyrë trashëgimtarëve të ish-pronarit Sh.M., pasi ka qenë e lirë në kuptim të ligjit dhe i përkiste atij përpara shtetëzimit. Në mënyrë abuzive, paditësi ka përdorur si argument thelbësor në proceset gjyqësore vendimin nr. 42, datë 12.02.2010 të kryeregjistruesit për fshirjen

e regjistrimit të pronës së kërkuarit, ndonëse kjo kompetencë e kryeregjistruesit ishte shpallur jokushtetuese me vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuarin. Po kështu, mospërbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjerë. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet vetëm në verifikimin e kriterit të legjitimitimit *ratione materiae* të kërkuarit.

15. Në këndvështrim të përmbushjes së këtij kriteri, i cili verifikohet në drejtim të natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në disa aspekte të saj, duke pretenduar se, për këtë shkak, i është cenuar edhe *e drejta e pronës private*. Kështu, sipas kërkuarit, është cenuar: (i) *parimi i barazisë së armëve*, për shkak të mënyrës së vlerësimit të provave dhe të aktit të ekspertimit nga gjykatat e faktit, si dhe mospranimit të kërkesës për riekspertim; (ii) *e drejta e aksesit* në Gjykatën e Lartë dhe *standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, për shkak të mungesës së pretenduar të përgjigjes ndaj argumenteve për origjinën dhe vlefshmërinë e titullit të pronësisë

së familjes Muhameti, ekzistencën e mbivendosjes dhe përparësinë ndërmjet titujve konkurrues; (iii) *parimi i sigurisë juridike*, për shkak të pasojave që vendimet gjyqësore të kundërshtuara dhe vendimi i kryeregjistruesit kanë sjellë, sipas tij, për fuqinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me të cilat prona u është njohur dhe kthyer në natyrë trashëgimtarëve të ish-pronarit Sh.M., si dhe për shkak të marrjes në konsideratë të vendimit të kryeregjistruesit, ndonëse me vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës ishte shpallur jokushtetuese kompetenca e tij për fshirjen e regjistrimeve të pronësisë.

16. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën, në vetvete, lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë haptazi ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në zbatim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në argumentet e parashtruara nga kërkuesi, Kolegji vëren se pretendimet që lidhen me mangësitë e aktit të ekspertimit, nevojën për kryerjen e një riekspertimi, ekzistencën dhe masën e mbivendosjes, si dhe origjinën ose përparësinë ndërmjet titujve të pronësisë kanë të bëjnë, në thelb, me përcaktimin e fakteve, vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit material nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesi kundërshton përfundimet në të cilat këto gjykata kanë arritur mbi bazën e provave të administruara në gjykim dhe kërkon që ato të vlerësohen ndryshe nga Gjykata. Megjithatë, ai nuk

ka parashtruar argumente që të evidentojnë se mënyra e përcaktimit të fakteve, vlerësimit të provave ose interpretimit të ligjit ka qenë haptazi arbitrare ose ka çuar në një rezultat që e bën gjykimin të padrejtë në kuptimin kushtetues. Po kështu, Kolegji vëren se fakti që gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar më bindëse provat e paraqitura nga njëra palë nuk provon *per se* cenimin e *parimit të barazisë së armëve*, për sa kohë kërkuuesi nuk ka evidentuar ndonjë pabarazi konkrete në mundësitë procedurale që u janë ofruar palëve për paraqitjen, njohjen dhe kundërshtimin e provave. Edhe mospranimi i kërkesës për riekspertim lidhet me mënyrën e administrimit dhe vlerësimit të provave dhe, si i tillë, nuk ngre një çështje kushtetuese, përderisa kërkuuesi nuk ka argumentuar se kjo ka cenuar në mënyrë thelbësore mundësinë e tij për të paraqitur çështjen ose për të kundërshtuar provat e palës tjetër.

19. Për sa u përket *së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, Kolegji vëren se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim padinë dhe provat mbi të cilat ajo mbështetej, si dhe pretendimet, kundërshtimet dhe konkluzionet e të paditurve, duke arsyetuar për origjinën e titujve të pronësisë, mbivendosjen e tyre dhe shkaqet për të cilat padia është gjetur pjesërisht e bazuar. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, ka vlerësuar se ato nuk bënin pjesë në shkaqet e parashikuara nga neni 472 i KPC-së, sipas formulimit në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit. Në këtë drejtim, ai ka arsyetuar se gjykata e apelit kishte respektuar ligjin material dhe procedural, se nuk evidentoheshin shkelje të rënda të normave procedurale dhe se pretendimet që lidheshin me vlerësimin e provave dilnin jashtë funksionit rishikues, me natyrë ligjore, të Gjykatës së Lartë. Kolegji çmon se vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk mund të vërë në dyshim të drejtën e kërkuessit për akses në atë gjykatë ose respektimin e standardit të arsytimit. Sipas jurisprudencës kushtetuese, vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit dhe arsyetimi të shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, arsyetimi i kufizuar nuk e përjashton detyrimin e Gjykatës së Lartë për t'u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, vendimtare për zgjidhjen e çështjes. Në rastin konkret, kërkuuesi nuk ka identifikuar ndonjë pretendim të tillë, të cilin Gjykata e Lartë ta

ketë lënë pa përgjigje, por kundërshton mënyrën sesi gjykatat kanë vlerësuar argumentet e tij për origjinën, vlefshmërinë dhe përparësinë e titullit të pronësisë.

20. Kolegji vëren, gjithashtu, se pretendimi për cenimin e sigurisë juridike nuk është mbështetur me argumente që evidentojnë një cenim me natyrë kushtetuese. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, të cilave u referohet kërkuesi, nuk rezultojnë të jenë shfuqizuar ose rishikuar nga gjykatat në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ato vendime kanë zgjidhur marrëdhënien juridike ndërmjet trashëgimtarëve të Sh.M. dhe organeve shtetërore përgjegjëse për njohjen dhe kthimin e pronës, ndërsa procesi i kundërshtuar kishte për objekt zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje ndërmjet subjekteve private që pretendonin tituj pronësie konkurrues mbi të njëjtën sipërfaqe. Për më tepër, shtetasi S.Xh. nuk rezultojnë të ketë qenë palë në proceset e mëparshme gjyqësore. Në këto rrethana, gjykatat e zakonshme në rastin konkret nuk kanë rihapur ose ndryshuar çështjen e zgjidhur me vendimet e formës së prerë, por kanë përcaktuar shtrirjen dhe efektet e titullit të pronësisë që buronte prej tyre në raport me një titull tjetër pronësie, duke vlerësuar se ai nuk mund të prodhonte pasoja mbi pjesën e pasurisë që i përkiste një subjekti privat. Një vlerësim i tillë lidhet me interpretimin dhe përcaktimin e efekteve të titujve të pronësisë dhe nuk përbën, në vetvete, cenim të fuqisë së gjësë së gjykuar. Po kështu, Kolegji vëren se nga përmbajtja e vendimeve të kundërshtuara nuk rezultojnë që përfundimi i gjykatave të zakonshme të jetë mbështetur në mënyrë vendimtare në vendimin nr. 42, datë 12.02.2010 të kryeregjistruesit. Ato gjykata kanë marrë në shqyrtim edhe titujt e pronësisë së palëve, aktin e ekspertimit dhe provat e tjera të administruara gjatë procesit, mbi bazën e të cilave kanë përcaktuar origjinën e pronësisë dhe ekzistencën e mbivendosjes. Për rrjedhojë, edhe duke pranuar premisën e kërkuesit për mungesën e kompetencës së kryeregjistruesit për të urdhëruar fshirjen e regjistrimit, kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se vendimmarrja gjyqësore në rastin konkret është mbështetur në një bazë haptazi arbitrare ose se është cenuar siguria juridike.

21. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit nuk arrijnë të evidentojnë *prima facie* cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe, për rrjedhojë, as cenimin e së drejtës së pronës private, ndaj këto pretendime janë haptazi të pabazuara.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.